

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË MALLIT NË TRANSPORT**Përcaktimet e përgjithshme:**

Kushtet e Sigurimit këtu e mëposhte do të quhen: Kushtet e Përgjithshme të Sigurimit .

Siguruesi: është Kompania e Sigurimeve INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP, e autorizuar sipas legjislacionit në fuqi.

I Siguruari: është individ/subjekti i emërtuar si I Siguruar në Policën e Sigurimit.

Polica e Sigurimit: është dokumenti që provon lidhjen e kontratës së sigurimit ndërmjet Siguruesit dhe të Siguarit.

Përfutjesi: është individ/subjekti i përcaktuar në Policën e Sigurimit.

Prim i Sigurimit: është shuma (e menjëhershme apo me këste) që i Siguruari i paguan Siguruesit për të blerë policën e sigurimit.

Format e mbulimit**Art. 1 Fusha e sigurimit**

Sigurimi mbulon rreziqet ndaj të cilëve mallrat janë të ekspozuara gjatë udhëtimit të siguruar, deri sa rreziqet specifike nuk janë përjashtuar shprehimisht. Format kryesore janë:-Art.2 Mbulimi i rrezikut C, -Art.3 Mbulimi i rrezikut B, - Art.4 Mbulimi i rrezikut

Art.2 Mbulimi i rrezikut C – Para 1982: "F.P.A"

Ky sigurim mbulon humbje, dëme dhe shpenzime të objektit të siguruar të shkaktuara nga:

- zjarr, eksplozion
- aksidente të mjeteve të transportit (përplasje, nxjerrje në breg, fundosje, ngecje në cektinë, përmbajtje, dalje nga shinat)
- shkarkimi i mallit në portin e fatkeqësisë
- sakrificat e avarisë së përgjithshme
- shpenzimet për shpëtimin e ngarkesës

Art. 3 Mbulimi i rrezikut B – Para 1982: "W.A."

Si "C", por shtohen:

- tërmeti, shpërthimi vullkanik , rrufeja
- rënia e ujit mbi bordin e anijes,
- dëmtime nga uji i detit ose i lumit,
- humbje totale e pakove të veçanta gjatë ngarkimit dhe shkarkimit.

Art.4 Mbulimi i rrezikut A – Para 1982: "Nga të gjitha rreziqet"

- nuk emërtohen rreziqet por mbulohen
- të gjitha rreziqet e humbjeve ose dëmeve të shkaktuara nga çdo ngjarje e rastit, e paparashikuar, aksidentale dhe e papritur.

Art. 5 Përjashtime në të tre format e mbulimit

Siguruesi në asnjë rast nuk mbulon humbje, dëme ose shpenzime të shkaktuara nga:

- qëndrimi i keq i paramenduar i të Siguarit
- rrjedhje e zakonshme, humbje e zakonshme në peshë dhe volum, konsum dhe amortizim i objektit të siguruar
- vese të brendshme ose të natyrës së objektit të siguruar
- vonesa edhe n.q.s kjo është shkaktuar nga një rrezik i siguruar
- paafërsia paguese ose me karakter financiar të pronarëve ose qiramarrësve të anijeve
- përdorimi i çdo lloj armatimi luftarak që mbështetet dhe shfrytëzon reaksionet atomike dhe nukleare, shpërthimin bërthamor ose reaksione të tjera të ngjashme ose nga forcat dhe lëndet radioaktive.

Për më tepër Siguruesi nuk është përgjegjës për:

- pavlefshmërinë e anijes ose e mjetit të transportit, kontenierit ose vënit transportues për mbajtjen e sigurt të objektit të siguruar, kur I Siguruari ose hallkat e tij janë në dijeni për këtë pavlefshmëri ose papërshtatshmëri në kohën kur ngarkohet objekti i siguruar

Siguruesi në asnjë rast nuk mbulon humbje, dëme ose shpenzime të shkaktuara nga:

- lufta civile, lufta, revolucionet ose akte armiqësore nga ose kundër një fuqie ndërluftuese

- kapja, mbajtja, arrestimi, kufizimi, ose pengimi dhe çdo pasojë ose përpjekje që lind nga kjo
- mina, silura, bomba, ose armë të tjera luftarake të lëna nga lufta
- punëtorët që kanë ndërprerë punën ose personat që marrin pjesë në trazirat e punës, turbullirat ose trazirat civile
- grevat, ndërprerjet e punës, trazirat ose grumbullimet civile
- çdo terrorist që vepron me motive politike

- sulmet kibernetike
- përjashtimi i sëmundjeve ngjitëse

Perioda e sigurimit**Art.12 Fillimi dhe përfundimi**

Ky sigurim fillon nga koha që mallrat lëvizin nga magazinat në vendin e caktuar për fillimin e tranzitimit, vazhdon gjatë kursit të zakonshëm të tranzitimit dhe përfundon:

- me dorëzimin të pritësi ose në magazinën përfundimtare ose në vendin e magazinimit në destinacionin e caktuar
- me dorëzimin në një magazinë tjetër që e zgjedh paraprakisht I Siguruari ose në vendin e destinacionit të caktuar për tu përdorur ose
- për depozitimin ndryshe nga kursi i zakonshëm i transportit për dhënie ose shpërndarje cilado që të ndodhë e para

Art.13 Vonesa

Ky sigurim do të mbetet në fuqi gjatë vonesave përtej kontrollit të të Siguarit, për çdo devijacion, shkarkim të detyruar, ringarkim ose transportim dhe gjatë çdo ndryshimi në avari detare që lindin nga e drejta që u lejohet pronarëve të anijeve ose qiramarrësve në bazë të kontratës së transportit.

Detyrimet në rast humbjes ose dëmsh**Art. 20 Njoftimi**

I Siguruari duhet të njoftojë Siguruesin brenda 48 orëve nga çasti që ka marrë dijeni për vërtetimin e ngjarjes së sigurimit dhe të marrë pa vonesë të gjitha masat për ruajtjen ose shpëtimin e mallrave dhe për minimizimin e humbjes së dëmit.

Art. 21 Ruajtja e të drejtave për rekurs

I Siguruari është i detyruar të ruajë të gjitha të drejtat për rekurs kundrejt personave të tretë të cilët mund të jenë përgjegjës për dëmin ose humbjen dhe përgjigjet për çdo veprim që çon në dëmtim të drejtës së rekursit. Në veçanti I Siguruari duhet të marrë keto masa:

- dëmet e dukshme i njoftohen me shkrim transportuesit përpara marrjes në dorëzim të mallrave
- kur mendohet se ka dëme të bëhen rezervimet e nevojshme brenda afateve ligjore ose të parashikuara në kontratë
- kur ka mosmarrëveshje për përcaktimin e madhësisë së dëmit, për vërtetimin e tij thirret edhe transportuesi

Art.22 Survejimi

Në rast humbjes ose dëmsh në Shqipëri, Siguruesi me inspektoret e tij duhet të thirret menjëherë për qëllime survejimi. Në qoftë se humbja ose dëmi ndodh jashtë Shqipërisë, duhet të njoftohet menjëherë survejori, adresa e të cilit është e shënuar në policën e sigurimit. Në rast se humbja ose dëmi nuk janë të dukshme nga ana e jashtme, survejimi duhet të kërkohet brenda javës së dorëzimit të mallrave tek pritësi.

Kërkesa ligjore

Art.26 Kur I Siguruari merr nga persona të tretë një pjesë të dëmshpërblimit për dëmin e pësuar Siguruesi detyrohet ti paguajë atij vetëm diferencën.

Art. 27 Marrëdhëniet ligjore në lidhje me kontratën e sigurimit

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga kontrata e sigurimit ndërmjet Siguruesit dhe të siguruarve, zgjidhen nga gjykata.

Kur të siguruar janë persona juridike ose fizike të huaj, mosmarrëveshjet do të zgjidhen sipas procedurave ndërkombëtare ose si të bihet dakort ndërmjet palëve.